

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kur do të kërkojë falje Veliaj për mashtrimet prej 405 ditësh?
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/kur-do-te-kerkoje-falje-veliaj-per-mashtrimet-prej-405-ditesh-i475308
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 07:26:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 06:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	48acb958b0cfe390ef29ea3bd3b0cfc26b3a0bf22940d84985c632a62477d5dc
TEKSTI	b0e72667fb355236306f38fbf40bdb35a96f725f7abe92dbdf3592621be0248a
PAMJA	4b9ad5f1cc4ff02be3632bfc1af0ca4ebd38f6a5b8c9e67f34f83bf650b60589

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aa611a3d220db22da53430a4e0d7b18f6704470dc193845346c10be90740c4b0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f fa3671555d7ae6cb03bad74ec6398ad3819e03f2270ea6128c9f6d225eb63a8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aa611a3d220db22da53430a4e0d7b18f6704470dc193845346c10be90740c4b0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

08:54 Aktualitet

Prej 405 ditësh kryebashkiaku i arrestuar i Tiranës me 13 ...

Kur do të kërkojë falje Veliaj për mashtrimet prej 405 ditësh?



27 Shtator 2026, 08:54, Aktualitet CNA



Prej 405 ditësh kryebashkiaku i arrestuar i Tiranës me 13 akuza për 5 vepra të rënda penale, Erion Veliaj, dhe gazetari i familjes së tij, Mero Baze, mashtruan dhe gënjyen opinionin publik, duke akuzuar prokurorin Ols Dado se ka nisur hetimet për shkak të konfliktit të interesit, ku sipas pretendimeve të tyre prokurori ka kërkuar shtesë mbi me lejen e ndërtimit, kërkesë që, sipas kryebashkiakut Veliaj, nuk e ka pranuar, ndaj dhe nisjen e hetimit ndaj tij e cilëson si "hakmarrje personale".

Mediat e paguara nga paratë e koncesioneve të pushtetit apo nga Arbër Veliaj, vëllait të kryebashkiakut Veliaj si "Report TV", "Tema" etj., të cilat që prej shkurtit të 2025, kohë kur edhe u arrestua Erion Veliaj, me megafonët e tyre të propagandës tentuan të manipulonin opinionin publik, duke krijuar aludime të rreme se prokurori i SPAK-ut, Ols Dado, po kryente hetime nga inati personal dhe kishte kërkuar leje për një shtesë ndërtimi mbi një pallat të ndërtuar në pronën e tij dhe 13 qytetarëve të tjerë.

'Ta tregoj unë ty', Veliaj për Report Tv: Dado në konflikt interesi, më kërkoi kate shtesë, më mirë bëj burg të padrejtë se shkel ligjin



Redaksia

6 Mars 2025, 21:06 | Përditësimi: 6 Mars 2025, 21:34

f Share

X Post



Erion Veliaj: Olsi Dado është në konflikt interesi 24h në 24! Ka kërkuar si Gobsek i pangopur metra shtesë, që nuk i takojnë, dhe nuk i ka marrë. Unë më mirë bëj burg të padrejtë, se të shkel ligjin, që Olsi të marrë kate shtesë, që nuk i takojnë, te Rruga e Kavajës.

Tema

Politika

Sociale

Kronika

Ekonomia

Editorial

Antena

Blog

Rajoni

Bota

Kulturë

Sport

Lifestyle


Kontakt



English

TE FUNDIT

Humanisë dhe Bullgarisë? • 07:51 SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kubë m • 07:42 Aksidenti i rëndë në Fushë-Krujë, ndërron jetë 19-vjeçari, plagosën dy të t



DOKUMENTAT - Zbardhen detaje nga seanca me dyer të mbyllura në GJKKO, Erion Veliaj - prokurorit Dado: E ke personale me mua, më je paraqitur dy herë për leje ndërtimi

12 SHKURT 2025, 10:04 / POLITIKA
TEMA

Më tej u lobua me qindra mijëra dollarë për raporte të mbushura me shpifje dhe gënjeshtër kundër drejtësisë, prokurorit Ols Dado dhe gjyqtarëve të cilit kishin lënë në burg Veliajn, ku ky i fundit prej më shumë se një viti nuk shkon në gjykatë të përballet me akuzat, por me skenarë dhe skema ka shtyrë pafundësisht seancat gjyqësore.

Sulmi vijoi me padi në Gjykatën Administrative kundër prokurorit, ku Veliaj mori një tjetër goditje nga institucionet e drejtësisë, pasi iu rrëzua.



"Grusht" në fytyrën e Veliajt/ Gjykata Administrative rrëzon padinë kundër Ols Dados

Pas 405 ditësh dhe pas kërkesash të njëpasnjëshme kundrejt këtij institucioni, një dokument zyrtar i vënë në dispozicion për CNA nga vetë Bashkia e Tiranës rrëzoi përfundimisht me fakte dhe prova këtë mashtrim të shëmtuar propagandistik, dhe dokumenti mban firmën e Alban Dokushit, Sekretarit të Përgjithshëm të komanduar, besnikut dhe krahut të djathtë të Erion Veliajt.



Dokushi përgënjeshtroi Veliajn dhe mashtruesit e tij/ Rrëzohen gënjeshttrat 405-ditore për Ols Dadon

 
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT
DREJTORIA E LEJEVE PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT

No. 29850/prot. Tiranë më, 24. 09. 2026

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. XHOVAN SHYTI
Administrator i CNA-City News Albania
Rruga "Selitë e Vjetër", zonë kadastrale 8270, Tiranë.
Email: info@cna.al, Cel: 0689099333

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 18.08.2026, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me Nr. 29850 Prot., datë 19.08.2026, ku kërkohet informacion lidhur me shtesën mbi sipërfaqen ndërtimore, miratuar me vendimin nr. U-14078/4, datë 09.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, dhe lejen e ndërtimit nr. U-14078/6, datë 21.09.2021, kërkuar nga shoqëria ALB-EDIL shpk, Drejtoria e Lejeve për Zhvillimin e Territorit ju bën me dije se:

Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik e-leje, për rastin në fjalë rezulton vetëm leja e ndërtimit e miratuar me Vendimin nr. U-14078/4, datë 09.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë, ndodhur në rrugën e "Bogdanëve", Njësia Administrative nr.10, Tiranë, në pronë të Terezina Adhami, Ols Dado, Zef Berisha, Eduard Berisha, Ana Shkreli, Franc Berisha, Frederik Berisha, Karmelina Berisha, Mike Berisha, Terezina Berisha, Xhilda Berisha, Atnand Dema, Roland Lloshi, Xhuljana Karruku, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria "ALB EDIL" sh.p.k.", të cilin e gjeni bashkëlidhur kësaj shkresë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
(i komanduar)
ALBAN DOKUSHI

Në shkresën e Dokushit theksohet se, në përgjigje të kërkesës së CNA-së, e cila u dërgua në datën 18 gusht 2026 dhe u protokollua pranë Bashkisë Tiranë në datën 19 gusht, Drejtoria e Lejeve për Zhvillimin e Territorit ka bërë me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik e-leje, për rastin në fjalë rezultoi vetëm leja e ndërtimit e miratuar me Vendimin nr. U-14078/4, datë 09.09.2021 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliq.

Objekti i miratuar është "godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë, ndodhur në Rugën e Bogdanëve, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë".



**BASHKIA
TIRANË**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

VENDIM

Nr.U-14078/4

PËR

Miratimin e lejesë ndërtimit për "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë, ndodhur në rrugën e "Bogdanëve", Njësia Administrative nr.10, Tiranë, në pronë të Terezina Adhami, Ols Dado, Zef Berisha, Eduard Berisha, Ana Shkreli, Franc Berisha, Frederik Berisha, Karmelina Berisha, Mike Berisha, Terezina Berisha, Xhilda Berisha, Atnand Dema, Roland Lloshi, Xhuljana Karruku, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria "ALB EDIL" sh.p.k.".

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr.133/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; nenet 29 dhe 39 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e KKT-së nr.4, datë 14.04.2017 "Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Tiranë"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.158, datë 26.12.2019 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar); Urdhëresën Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ndërtimit, deklaratë paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); "Urdhrin nr. 11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); Planit të Detajuar Vendor të njësise strukturore TR/362, Faza e Parë, miratuar me vendimin nr. 28833 datë 29.07.2019, të Kryetarit të Bashkisë dhe Planit të Detajuar Vendor të njësise strukturore TR/362, Faza e Dytë, zona 1, miratuar me vendimin nr. 29450/1, datë 25.07.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe mbështetur në opinionin e datës 01.09.2021 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës

qortezuar elektronikisht me numër aplikimi AN250620210051 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. U-14078, datë 25.06.2021, për leje ndërtimi për "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë", ndodhur në rrugën e "Bogdanëve", në njësinë strukturore TR/362, Njësia Administrative nr.10, Tiranë, në pronë të Terezina Adhami, Ols Dado, Zef Berisha, Eduard Berisha, Ana Shkreli, Franc Berisha, Frederik Berisha, Karmelina Berisha, Mike Berisha, Terezina Berisha, Xhilda Berisha, Atnand Dema, Roland Lloshi, Xhuljana Karruku, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria "ALB EDIL" sh.p.k.",

VENDOSA:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Godinë banimi dhe shërbimi 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë" ndodhur në rrugën e "Bogdanëve", në njësinë strukturore TR/362, Njësia Administrative nr.10, Tiranë, në pronë të Terezina Adhami, Ols Dado, Zef Berisha, Eduard Berisha, Ana Shkreli, Franc Berisha, Frederik Berisha, Karmelina Berisha, Mike Berisha, Terezina Berisha, Xhilda Berisha, Atnand Dema, Roland Lloshi, Xhuljana Karruku, me zhvillues dhe subjekt ndërtues shoqëria "ALB EDIL" sh.p.k.",

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.